

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Bazat e Auditimit të
Brendshëm
Internal Audit Basics**

B2

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Nr.

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'JU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT

Do Not Open Until Your invigilator Allows You to Do So.

2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE
All Questions Are Mandatory

3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours

4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË TË
KËTIJ PROVIMI.

Your name should appear nowhere in this test.

Data 16.06.2018

CONTENT / PËRMBAITJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA</u>
1. Pyetje (50 x 2 pikë)	100	
Total	100	

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

1. Rreziku matet në terma të së cilës nga të listuarat më poshtë?
 - A. Kostove dhe çmimeve.
 - B. Kostove dhe përfitimeve.
 - C. Ndikimit dhe gjasave.
 - D. Fitimit dhe humbjes.

2. Cila nga deklaratat e mëposhtme është e vërtetë në lidhje me Standardet e Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm (IIA)?
 - A. Standardet e Veçorive aplikohen ndaj aktiviteteve tradicionale të auditimit të brendshëm.
 - B. Standardet e Performancës aplikohen ndaj aktiviteteve të këshillimit.
 - C. Standardet e Veçorive, Standardet e Performancës dhe Standardet e Implementimit aplikohen ndaj të gjitha aktiviteteve dhe shërbimeve të sigurisë dhe këshillimit.
 - D. Standardet e Implementimit aplikohen ndaj shërbimeve të sigurisë, por jo ndaj shërbimeve të këshillimit.

3. Në mjedise të mëdha dhe komplekse të auditimit të brendshëm, cili nga të mëposhtmit administron dhe monitoron aktivitetet e nevojshme për një program të suksesshëm të sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit?
 - A. Shefi Ekzekutiv i Auditimit.
 - B. Shefi Ekzekutiv i Auditimit të Brendshëm.
 - C. Shefi Ekzekutiv i Shërbimeve të Sigurisë.
 - D. Shefi Ekzekutiv i Shërbimeve të Këshillimit.

4. Cila nga konceptet e mëposhtme të rrezikut mund të supozohet të mos ketë kontrolle lehtësuese?
 - A. Rreziku i biznesit.
 - B. Rreziku i mbetur.
 - C. Rreziku i vetvetishëm.
 - D. Rreziku aktual.

5. Regjistrat e rrezikut dokumentojnë rreziqet deri në cilin nivel, të listuar mëposhtë?
 - A. Nën nivelin teknik.
 - B. Nën nivelin operativ.
 - C. Nën nivelin funksional.
 - D. Nën nivelin strategjik.

6. Një organizatë, ishte në procesin e krijimit të departamentit të ri të auditimit të brendshëm. Kontrolli i brendshëm nuk kishte përvojë të mëparshme me auditorët e brendshëm. Për shkak të mungesës së përvojës, kontrolli i brendshëm e këshilloi departamentin e auditimit të brendshëm të raportonin tek auditorët e jashtëm. Megjithatë, shefi ekzekutiv i ri i auditimit (CAE) do të kishte qasje të lirë tek kontrolli i brendshëm për të raportuar ndonjë gjë të rëndësishme. Kontrolli i brendshëm do të përcjell shqetësimet e shefit ekzekutiv të ri të auditimit tek bordi i drejtorëve. Cila nga të mëposhtmet është e vërtetë?
 - A. Departamenti i auditimit të brendshëm do të jetë i pavarur, meqenëse shefi ekzekutiv i ri i auditimit ka qasje direkte tek bordi i drejtorëve.
 - B. Departamenti i auditimit të brendshëm nuk do të jetë i pavarur, për shkak se shefi ekzekutiv i ri i auditimit raporton tek auditorët e jashtëm.
 - C. Departamenti i auditimit të brendshëm nuk do të jetë i pavarur, meqenëse kontrolli i brendshëm nuk ka përvojë me auditorët e brendshëm.
 - D. Departamenti i auditimit të brendshëm nuk do të jetë i pavarur, meqenëse kompania nuk e ka specifikuar se kandidatët e departamentit të auditimit të brendshëm duhet të jenë auditorë të brendshëm të çertifikuar.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

7. Cila nga këto është qëllimi kryesor i kryerjes së procedurave analitike në auditim të brendshëm?
- A. Të kryejë procedura shtesë të auditimit.
 - B. Të planifikojë angazhimin e auditimit.
 - C. Të sigurojë evidencë të auditimit.
 - D. Të studiojë marrëdhëniet ndërmjet elementeve të informacionit.
8. Aktiviteti ndjekës (follow-up) mund të kërkohet për të siguruar se veprimet korigjuese janë kryer për gjetjet e caktuara. Përgjegjësia e departamentit të auditimit të brendshëm për të kryer aktivitete ndjekëse (follow-up) ashtu siç kërkohet, duhet të përcaktohet në:
- A. Statutin e shkruar të departamentit të auditimit të brendshëm.
 - B. Deklaratën e misionit të komitetit të auditimit.
 - C. Memorandumin e angazhimit të lëshuar para çdo angazhimi të auditimit.
 - D. Deklaratën e qëllimit në raportet e zbatueshme të auditimit.
9. Shpesh auditorët e brendshëm thirren qoftë për të kryer ose për të asistuar auditorët e jashtëm në kryerjen e rishikimit të kujdesit të duhur (due diligence). Rishikimi i kujdesit të duhur (due diligence) është:
- A. Rishikim i pasqyrave financiare të ndërmjetme sipas udhëzimeve të një firme sigurimi.
 - B. Auditim operacional i një sektori të një kompanie me qëllim që të përcaktojë nëse menaxhmenti i sektorit është në përputhje me ligjet dhe rregulloret.
 - C. Rishikim i operacioneve siç kërkohet nga komiteti i auditimit për të përcaktuar nëse operacionet janë në përputhje me komitetin e auditimit dhe politikat organizative.
 - D. Rishikim i pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese (shpalosjeve) në lidhje me një blerje të mundshme.
10. Sipas Standardeve të Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm (IIA) cila nga të mëposhtmet më së miri përshkruan natyrën e opinioneve që janë të përshtatshme për raportet e auditimit të brendshëm?
- A. Në përgjithësi, opinionet janë gjykime subjektive të auditorit në lidhje me faktin se përse ekzistojnë mangësitë.
 - B. Opinionet janë vlerësime të auditorit për efektet e vëzhgimeve dhe rekomandimeve në lidhje me aktivitetet e shqyrtuara.
 - C. Opinionet janë konkluzione të nxjerra nga auditori në lidhje me përshtatshmërinë e objektivave të të audituarit.
 - D. Opinionet duhet të përfshijnë vetëm paanësinë e pasqyrave financiare të të audituarit.
11. Gjatë një auditimi të blerjeve, auditorët e brendshëm gjetën disa shkelje të politikës së kompanisë lidhur me ofertat konkurruese. E njëjta gjetje ishte raportuar vitin e kaluar në raportin e auditimit dhe nuk ishin ndërmarr masa korigjuese. Cila nga të mëposhtmet e përshkruan më së miri veprimin e duhur në lidhje me këtë gjetje, të përsëritur?
- A. Raporti i auditimit duhet të theksojë se gjetja e njëjtë është raportuar edhe në auditimin paraprak.
 - B. Gjatë intervistës përmbyllëse, menaxhmentit duhet t'i bëhet me dije se gjetja nga raporti paraprak nuk ishte korigjuar.
 - C. Shefi ekzekutiv i auditimit të brendshëm duhet të përcaktojë nëse menaxhmenti apo bordi ka marr përsipër rrezikun që të mos ndërmarrë veprime korigjuese.
 - D. Shefi ekzekutiv i auditimit të brendshëm duhet të përcaktojë nëse kjo gjendje duhet t'i raportohet auditorit të pavarur dhe çdo agjencie rregullatore.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

12. Politika e auditimit kërkon që raportet përfundimtare të mos lëshohen pa përgjigje të menaxhmentit. Një auditim me gjetje të rëndësishme është i plotë, përveç që mungon përgjigjia nga menaxhmenti. Vlerësoni kurset e mëposhtme të veprimit dhe zgjidhni alternativën më të mirë.
- A. Lëshoni një raport të përkohshëm lidhur me çështjet e rëndësishme të theksuara.
 - B. Modifikoni politikën e auditimit për të lejuar një periudhë të caktuar kohore për përgjigjen e menaxhmentit.
 - C. Prisni për përgjigjen e menaxhmentit dhe lëshoni raportin e auditimit.
 - D. Diskutoni situatën me auditorët e jashtëm.
13. Standardet e IIA kërkojnë nga drejtori i auditimit të brendshëm që të krijojë dhe mbajë një program të sigurimit të cilësisë për të vlerësuar funksionimin e departamentit të auditimit të brendshëm. Cila nga të mëposhtmet lidhet më drejtpërdrejt me objektivin e ruajtjes së cilësisë së lartë në të gjitha auditimet?
- A. Rishikimi mbikëqyrës i duhur i të gjitha programeve të auditimit, dokumenteve të punës dhe draft raporteve të auditimit.
 - B. Koordinimi i duhur me auditorët e jashtëm.
 - C. Pajtueshmëria e duhur me Kodin e Etikës të Institutit të Auditorëve të Brendshëm.
 - D. Standardet e edukimit të duhura për të gjithë anëtarët e stafit të auditimit profesional.
14. Gjatë auditimit të funksionit të llogarisë së pagueshme të organizatës, një auditor i brendshëm planifikon të konfirmojë bilancet me furnitorët. Cili është burimi i autoritetit për kontakte të tilla me njësitë jashtë organizatës?
- A. Politikat dhe procedurat e departamentit të auditimit të brendshëm.
 - B. Standardet e IIA-së.
 - C. Udhëzuesit e Praktikës së IIA-së.
 - D. Statuti i departamentit të auditimit të brendshëm.
15. Statuti i departamentit të auditimit të brendshëm duhet të:
- A. Autorizojë qasjen në të dhënat, personelin dhe pronat fizike të lidhura me kryerjen e auditimit.
 - B. Ofrojë formate të rekomanduara për të raportuar gjetjet dhe rekomandimet e rëndësishme të auditimit.
 - C. Përshkruajë programet e auditimit që do të kryhen.
 - D. Përcaktojë orarin e punës të departamentit të auditimit, planin e personelit dhe buxhetin financiar.
16. Siç përdoren nga profesioni i auditimit të brendshëm, Standardet e IIA-së i referohen të gjitha këtyre, përveç:
- A. Kriteve me të cilat vlerësohen dhe maten operacionet e departamentit të auditimit të brendshëm.
 - B. Kriteve që diktojnë nivelin minimal të veprimeve etike që duhet të ndërmerren nga auditorët e brendshëm.
 - C. Deklaratave që synojnë të përfaqësojnë praktikën e auditimit të brendshëm siç duhet të jetë.
 - D. Kriteve që janë të zbatueshme për të gjitha llojet e departamenteve të auditimit të brendshëm.
17. Në një rishikim të programeve të garancisë për produkte të reja të prezantuara nga një kompani me fitime të ulëta dhe në rënie, një auditor ka përcaktuar dhe menaxhmenti ka pranuar se kompania nuk do të jetë në gjendje të përmbushë sigurimin e premtuar të garancisë. Auditori duhet të:
- A. Informojë autoritetet përkatëse rregullatore.
 - B. Informojë konsumatorët.
 - C. Informojë komitetin e auditimit.
 - D. Jap dorëheqje nga punëdhënësi.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

18. Cila nga të mëposhtmet do të përbënte një shkelje të Kodit të Etikës të IIA?
- A. Janice ka pranuar një detyrë për të audituar departamentin e prodhimit të aparaturave elektronike. Kohët e fundit ajo është bashkuar me departamentin e auditimit të brendshëm. Por ajo ishte auditore e lartë për auditimin e jashtëm të atij departamenti dhe ka audituar shumë kompani të aparaturave elektronike gjatë dy viteve të fundit.
 - B. George është caktuar për të bërë një auditim të funksionit të magazinimit për gjashtë muajt e ardhshëm. Ai nuk ka ekspertizë në atë fushë por megjithatë e ka pranuar angazhimin. Ai është regjistruar për të ndjekur sesionet e edukimit të vazhdueshëm profesional rreth magazinimit, që do të përfundojnë para se të fillojë angazhimi i tij.
 - C. Jane është e kënaqur me karrierën e saj si auditore e brendshme dhe tani i duket si punë e rregullt/normal nga ora 9 deri në orën 5. Gjatë tre viteve të fundit, ajo nuk është angazhuar për të ndjekur sesione të edukimit të vazhdueshëm profesional ose në aktivitete të tjera për të përmirësuar efektivitetin e saj. Megjithatë, ajo ndjen se po kryen punë me të njëjtën cilësi që ajo gjithmonë e ka pasur.
 - D. John zbuloi një mashtrim të brendshëm financiar gjatë vitit. Librat u rregulluan për të pasqyruar siç duhet humbjen e lidhur me mashtrimin. Gjoni diskutoi mashtrimin me auditorin e jashtëm kur auditori i jashtëm shqyrtoi dokumentet e punës që detajonin incidentin.
19. Ju punoni për një organizatë që ka adoptuar një politikë të konfliktit të interesit që ndalon çdo veprimtari që është në kundërshtim me interesat dhe mirëqenien më të mirë të organizatës. Cila nga deklaratat e mëposhtme duhet të përfshihet në politikë për të ilustruar sjelljen e papranueshme?
- A. Të shërbyerit si anëtar i bordit të drejtorëve të organizatës jofitimprurëse të dedikuar për ruajtjen e mjedisit.
 - B. Të shërbyerit si zyrtar i zgjedhur të një qeverie lokale (me kohë të pjesshme).
 - C. Sigurimi i një liste adresash të punonjësve të kompanisë për një të afërm i cili ofron trajnime prej të cilave mund të përfitojë organizata.
 - D. Mësimdhënia (me kohë të pjesshme) në një universitet lokal.
20. Shefi i kryesues i auditimit (CAE) i një kompanie është në dijeni të mungesës materiale të inventarit të shkaktuara nga mangësitë e kontrollit të brendshëm në një fabrikë prodhimi. Mungesa dhe shkaqet e ndërlidhura janë të një rëndësie të mjaftueshme për të ndikuar në raportin e auditorit të jashtëm. Bazuar në Kodin e Etikës të IIA-së, identifikoni kursin më të përshtatshëm të veprimit të CAE-së:
- A. Mos thuaj asgjë; mbrojtje kundër ndërhyrjes në pavarësinë e auditorëve të jashtëm.
 - B. Diskutoni çështjen me menaxhmentin dhe ndërmerrni veprimet e duhura për të siguruar që auditorët e jashtëm janë të informuar.
 - C. Informoni auditorët e jashtëm për mundësinë e mungesës, por lejoni që ata të bëjnë një vlerësim të pavarur të shumës.
 - D. Raportoni mungesat në bordin e drejtorëve dhe u lejoni atyre që ta raportojnë atë tek auditori i jashtëm.
21. Cila nga praktikat e mëposhtme të menaxhimit përfshin përqendrimin në fusha që meritojnë vëmendjen dhe vijnë më pak vëmendje në fushat që funksionojnë siç pritet?
- A. Menaxhimi sipas objektivave (MBO).
 - B. Kontabiliteti i përgjegjësive.
 - C. Krahasueshmëria.
 - D. Menaxhimi me përjashtim (MBE).

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

Nga 2 pikë secila

22. Funkzioni i auditimit të brendshëm të një organizate është pjesë përbërëse e sistemit të përgjithshëm të kontrollit të brendshëm të organizatës. Zgjidhni llojin e kontrollit të theksuar nga një auditim operativ.
- A. Kontrollat reagues.
 - B. Planet strategjike.
 - C. Politikat dhe procesurat.
 - D. Kontrollat për të ardhmen.
23. Auditori përdori aftësitë raportuese të gjeneratës së katërt (4GL) për të analizuar skedarët e të dhënave për aktivitete të pazakonta, të tilla si orët e tepërta jashtë orarit, luhatjet e pazakonta në normat e pagave ose koha e tepruar e pushimeve. Kontrollat e aplikimit që janë verifikuar nga kjo analizë janë:
- A. Kontrollat e editimit dhe validimit.
 - B. Kontrollat e refuzimit dhe artikullit pezull.
 - C. Kontrollimi i përditësimit të qasjes në bazën e të dhënave.
 - D. Kontrollat e programuara të balancimit.
24. Cilat nga komponentët COSO përfshijnë shumë kontrolle të buta?
- I. Mjedisi i kontrollit.
 - II. Vlerësimi i rrezikut
 - III. Aktivitetet e kontrollit.
 - IV. Informimi dhe komunikimi.
 - V. Monitorimi.
- A. I dhe II.
 - B. I dhe III.
 - C. II dhe V.
 - D. I, III, dhe IV.
25. Sipas raportit COSO, plani vjetor i auditimit duhet të bazohet në cilën nga të mëposhtmet?
- I. Modeli i kontrollit.
 - II. Modeli i rrezikut.
 - III. Modeli i resurseve.
 - IV. Modeli i menaxhimit.
- A. Vetëm I.
 - B. Vetëm II.
 - C. I dhe II.
 - D. III dhe IV.
26. Auditorët rregullisht vlerësojnë kontrollet dhe procedurat e kontrollit. Cila nga të mëposhtmet më së miri përshkruan konceptin e kontrollit, ashtu siç njihet nga auditorët e brendshëm?
- A. Menaxhmenti shkarkon rregullisht personelin që nuk përmbush pritshmëritë.
 - B. Menaxhmenti ndërmerr masa për të rritur gjasat që synimet dhe objektivat e vendosura të arrihen.
 - C. Kontrolli paraqet procedurat specifike që kontabilistët dhe auditorët dizajnojnë për të siguruar korrektësinë e përpunimit.
 - D. Procedurat e kontrollit duhet të dizajnohen nga poshtë lart për të siguruar vëmendje në detaje.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

27. Auditorët e brendshëm do të kishin më shumë gjasa të zbulonin mashtrimin nëse ata kanë zhvilluar / fuqizuar aftësinë e tyre për të:

- A. Njohur dhe pyetur rreth ndryshimeve që ndodhin në organizata.
- B. Marrë në pyetje autorët e mashtrimit, për të zbuluar pse është kryer mashtrimi.
- C. Zhvilluar kontrole të brendshme për të parandaluar ndodhjen e mashtrimit.
- D. Dokumentuar programet kompjuterike të sistemit operativ.

28. Një mashtrim domethënës nga punonjësit ndodhi menjëherë pas një auditimi të brendshëm. Auditori i brendshëm mund të mos ketë përmbushur siç duhet përgjegjësinë për parandalimin e mashtrimit dhe kështu ka dështuar të theksojë dhe raportojë se:

- A. Politikat, praktikat dhe procedurat për të monitoruar aktivitetet dhe ruajtjen e pasurive ishin më pak të zgjeruara në zonat me rrezik të ulët sesa në zonat me rrezik të lartë.
- B. Një sistem kontrolli që varet nga ndarja e detyrave mund të anashkalohet nga bashkëpunimi midis tre punonjësve.
- C. Nuk kishte politika të shkruara që përshkruanin aktivitetet e ndaluara dhe veprimet e kërkuara sa herë që zbulohen shkeljet.
- D. Punonjësit e departamentit nuk ishin trajnuar siç duhet për të dalluar nënshkrimet në mirëbesim dhe ato të falsifikuara në forma të autorizimit.

29. Departamenti i personelit është përgjegjës për procesimin e tarifave të agjencive të vendosjes për të punësuarit e rinj. Një rekrutues krijoi disa agjenci false të vendosjes. Gjatë intervistimit të kandidatëve të rinj (hyrës), rekrutuesi do të rendiste një nga agjencitë e rreme si referues të kandidatit. Një mjet i mundshëm për zbulimin ose parandalimin është që të:

- A. Procesoni të gjitha faturat e personelit të agjencisë nëpërmjet një urdhërblërjeje përmes departamentit të blerjes.
- B. Verifikoni furnitorët e rinj kundrejt firmave të listuara në një katalog të shoqatave profesionale dhe / ose verifikoni emrin dhe adresën e furnitorit nëpërmjet librit të telefonit.
- C. Monitoroni afërsinë e marrëdhënieve të rekrutuesve me furnitor të veçantë.
- D. Kërkojuni të gjithë të punësuarve të nënshkruajnë një deklaratë vjetore të konfliktit të interesit.

30. Menaxhmenti i një organizate jofitimprurëse ka monitoruar shpenzimet dhe është i shqetësuar për shkak se pagesat ndaj disa furnitorëve duken të jenë jashtëzakonisht të larta. Shumica e blerjeve bëhen përmes funksionit të blerjes, i cili organizohet rreth tre blerësve, secili me fusha të përcaktuara blerëse. Agjentët e blerjeve vendosin urdhërblërjet dhe marrin kopje të raporteve të pranimit për të siguruar që mallrat janë pranuar. Ata i rishikojnë raportet dhe i krahasojnë ato me urdhër-blërjet dhe me miratimin e tyre për pagesë përpara se t'i regjistrojnë në llogaritë e pagueshme. Të gjitha faturat e furnitorëve dërgohen drejtpërdrejt në llogaritë e pagueshme edhe pse raportet e pranimit të parë kalojnë nëpër agjentët e blerjeve. Organizata ka një politikë që kërkon tre oferta për të gjitha blerjet që tejkalojnë 10,000€.

Cila nga këto, nëse vëzhgohet, nuk do të shfaqte nevojën për të kërkuar tregues të tjerë të mashtrimit?

- A. Standardi i jetesës së njërit prej agjentëve blerës është rritur.
- B. Struktura e kontrollit të brendshëm ka dobësi të konsiderueshme.
- C. Menaxhmenti, sipas kërkesës së agjentëve të blerjes, ka miratuar një politikë të pagesës së furnitorëve mbi një bazë më të duhur për të shmangur pagesat e dënimit.
- D. Kostoja e mallrave të blera duket të jetë më e lartë në krahasim me vitet e mëparshme.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

31. Kur krahasojmë autorët e krimeve që kanë përvetësuar fondet e kompanisë ndaj kryerësve të mashtrimit të pasqyrave financiare (pasqyrat financiare të falsifikuara), ata që kanë falsifikuar pasqyrat financiare do të kishin më pak gjasa të:

- A. Kenë përjetuar një stil autokratik të menaxhimit.
- B. Jetonin përtej mundësive të tyre të financimit.
- C. Racionalizonin sjelljen mashtruese.
- D. Përdornin pritjet e kompanisë si justifikim për aktin.

32. Roni dhe Gjoni kishin njohur njëri-tjetrin për shumë vite. Ata ishin bërë miq të mirë që në kolegji, ku të dy diplomuan në kontabilitet. Pas diplomimit, Roni mori në mbikëqyrje biznesin e familjes nga babai i tij. Familja e tij kishte një biznes ushqimor për disa breza. Kur Gjoni kishte vështirësi në gjetjen e një pune, Roni i ofroi atij punë në dyqanin e familjes. Gjoni dëshmoi të qenit një punonjës shumë i aftë. Ndërsa Gjoni demonstroi aftësitë e tij, Roni filloi të delegonte gjithnjë e më shumë përgjegjësi ndaj tij. Pas një periudhe kohore, Gjoni po kryente të gjitha autorizimet dhe funksionet e përgjithshme të kontabilitetit për çeqet, paratë, stoqet, dokumentet, regjistrimet dhe harmonizimet e deklaratave bankare.

(I) Gjoni u konsiderua plotësisht i besueshëm dhe trajtoi të gjitha funksionet financiare. Askush nuk e kontrollonte punën e tij. Roni vendosi të zgjerojë biznesin dhe hapi disa dyqane të reja.

(II) Roni trajtonte gjithmonë problemet më urgjente ... profesorët e tij të kolegjit e kishin quajtur "menaxher i krizës". Gjoni e ndihmonte me problemet kur punët e tjera të tij i lejonin kohë. Ndonëse ishte i suksesshëm në punë, Gjoni kishte vështirësi me problemet financiare personale.

(III) Në fillim, shumat që Gjoni vodhi ishin të vogla. Ai as nuk u shqetësua për të bërë bilancin e llogarive. Por Gjoni u bë lakmitar. "Sa e lehtë është të marrësh para," tha ai. Ai ndjeu se ai ishte një anëtar kritik i ekipit të biznesit, dhe se ai kontribuoi shumë më shumë në suksesin e kompanisë sesa ishte përfaqësuar nga paga e tij.

(IV) Do të duheshin dy ose tre vetë për të më zëvendësuar, ai shpesh mendonte për vetveten. Ndërsa shumat bëheshin çdo herë e më të mëdha, ai bëri bilancin e librave.

(V) Për shkak të këtyre aktiviteteve, Gjoni ishte në gjendje të blente një makinë të shtrenjtë dhe të merrte familjen e tij në disa udhëtime çdo vit.

(VI) Ai gjithashtu u bashkua me një klub të shtrenjtë të vendit. Gjithsesi, gjërat ndryshonin në shtëpi. Familja e Gjoniut vuri re se shpesh ai ishte argumentues dhe në raste të tjera shumë në depresion.

(VII) Mashtrimi vazhdoi për gjashtë vjet. Çdo vit biznesi performoi gjithnjë e më keq. Në vitin e kaluar dyqanet humbën mbi 200,000 €. Banka e Ronit kërkoi një auditim. Gjoni u rrëfye kur mendoi se auditorët kishin zbuluar përvetësimet e tij.

Kur diskutohen mashtrimet, shpesh janë identifikuar presionet, mundësitë dhe racionalizimet që shkaktojnë/lejojnë një keqbërës që të kryejë mashtrimin. Gjithashtu janë studiuar simptomat e mashtrimit.

Identifikoni faktorët e numëruar dhe të nënvizuar (nga skenari) si një nga simptomat, presionet, mundësitë ose racionalizimet e dhëna. **Numri (V), "ai bëri bilancin e librave"**, është një shembull i një:

- A. Simptome fizike.
- B. Simptome analitike.
- C. Simptome jetese.
- D. Simptome të dokumentuar.

33. Një auditor i brendshëm do të ishte i shqetësuar për mundësinë e mashtrimit nëse:

- A. Paraja e gatshme e pranuar, neto nga shumat e përdorura për të paguar shpenzimet që paguhen përmes parasë së imët-petty cash, depozitohet në bankë çdo ditë.
- B. I njëjtë punëtor i cili mban të dhënat e stoqeve të përhershme kryen harmonizimin bankar mujor.
- C. I njëjti person mban librin e llogarive të arkëtueshme dhe librin e llogarive të pagueshme.
- D. Një person, duke vepruar vetëm, ka qasje të vetme në fondin e parasë së imët – petty cash (përveç të dispozitës së kontrolleve të papritura rastësore nga mbikëqyrësi ose auditori).

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

34. Xhina Morina ishte menaxhere rajonale e shitjeve për një kompani për më shumë se dhjetë vite. Gjatë kësaj kohe ajo ishte bërë mike shumë e afërt me Fredi Hotin, një menaxher i auditimit të brendshëm. Përveç që ishin fqinjë, Xhina dhe Fredi kishin interesa shumë të njëjtat dhe i përkisnin të njëjtit klub tenisi. Ata i besonin njëri-tjetrit. Fredi i kishte ndihmuar Xhinës të zgjidhte disa probleme shitjesh dhe Xhina i kishte dhënë Fredit disa informata që çuan në zbulime të rëndësishme të auditimit gjatë tri auditimeve të kaluara. Të dhënat analitike të kompanisë kanë shtyrë stafin e auditimit të besojë se ka pasur një mashtrim të pasqyrave financiare. Kryerësi duket se ka falsifikuar informacionin e shitjes për dy vitet e fundit. Fredi është i shqetësuar për shkak se ai kohët e fundit ka përfunduar një auditim në këtë fushë dhe ka pranuar shpjegimin e Xhinës për dallimet në të dhënat analitike. Fredi tani është i bindur se Xhina është e përfshirë në mashtrime.

Dilema aktuale në të cilën Fredi e gjen veten, ishte më së paku e shkaktuar nga:

- A. Mos bërja e rotacionit të angazhimeve të auditimit çdo vit.
- B. Pranimi i angazhimit në auditim në një fushë ku ai ishte mik i ngushtë i menaxheres.
- C. **Dështimi për të zgjedhur procedurat e duhura analitike.**
- D. Pranimi i përgjigjes së menaxhmentit pa testime shtesë të auditimit.

35. Menaxhmenti i një kompanie sigurimi të pronave dhe viktimave është i shqetësuar për efikasitetin dhe efektivitetin e aktiviteteve të përpunimit të kërkesave. Menaxhmenti ka dy shqetësime kryesore: (1) Janë paguar disa kërkesa që nuk duhet të paguhen ose janë paguar në shuma që tejkalojnë politikën e kompanisë; dhe (2) shumë paditës nuk janë paguar në kohën e duhur. Në përgatitjen e një auditimi të kësaj fushe, auditori i brendshëm vendos të kryejë një studim paraprak për të mbledhur më shumë informacion rreth natyrës së përpunimit të kërkesave dhe problemeve të mundshme.

Mbikëqyrësi ka një ndryshim në thelb dhe tregon se shuma e mashtrimit ishte më pak se 85,000 euro nga 85 milionë euro në kërkesat e përpunuara, shumë jomateriale sipas mendimit të mbikëqyrësit. Mbikëqyrësi bën një ofertë për: (1) emërtimin e të gjithë punonjësve të përfshirë; (2) të përshkruaj anashkalimin e kontrolleve që lejojnë mashtrimin; dhe (3) të zbatojë kontrollet e nevojshme nëse auditori do të binte dakord të përshkruante situatën si avari/dobësim të procedurës së kontrollit dhe të mos e raportojë atë si mashtrim tek menaxhmenti. Shumat përfaqësojnë më pak se 0.1% të kërkesave të përpunuara. Përndryshe, mbikëqyrësi nuk do të bashkëpunojë në hetim, do të urdhërojë të tjerët të përfshirë që të mos bashkëpunojnë dhe do të angazhojë avokat ligjor.

Auditori tashmë është shumë mirë me buxhetin e kohës dhe është i intriguar nga mundësia për të negociuar përfundimin e hetimit dhe për të përmirësuar procedurat e kontrollit. Cila nga të mëposhtmet do të përfaqësonte një përgjigje të përshtatshme ndaj mbikëqyrësit?

- (I) Tregoni se situata është e hapur për negociata, por do të nevojiten më shumë detaje mbi natyrën e mashtrimit dhe mbikëqyrësi do të duhet të nënshkruajë një marrëveshje për kompromisin e arritur.
- (II) Tregoni se auditori nuk ka autorizim për të negociuar.
- (III) Tregoni se nëse mbikëqyrësi dëshiron të negociojë, çështja duhet së pari të raportohet si mashtrim dhe negociatat duhet të bëhen me menaxhmentin.

- A. Vetëm I.
- B. Vetëm II.
- C. Vetëm III.
- D. **I, II dhe III.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

36. Menaxheri i auditimit po zhvillon takimin vjetor me menaxhmentin e departamentit të prodhimit për të diskutuar planet dhe aktivitetet e propozuara të auditimit për vitin e ardhshëm. Pas disa diskutimeve rreth aktivitetit të auditimit të vitit të kaluar në 12 impiantet e departamentit, zëvendësdrojtori i departamentit pajtohet që të gjitha rekomandimet e rëndësishme të bëra nga stafi i auditimit i referohen kontrolleve kyçe dhe aktiviteve operative që lidhen me të, të përshkruara në mënyrë korrekte për menaxhmentin lokal brenda vëllimit të procedurave standarde të operacioneve për departamentin. Zëvendësdrojtori propozon të transkriptojë aktivitetet kyçe të kontrollit nga procedurat e gjera të shkruar të departamentit në një pyetësor të vetë-auditimit të procedurës standarde të operacioneve vetëvlerësimit (PSO/SOP). Çfarë rëndësie duhet t'i bashkangjes, menaxheri i auditimit, pyetësorit të tillë të PSO/SOP në lidhje me planin e propozuar të auditimit për vitin e ardhshëm?

- A. Pyetësorët e PSO/SOP do të përmirësojnë përshtatshmërinë e kontrollit, por auditorët duhet të verifikojnë se kontrollet po punojnë siç janë dokumentuar në PSO/SOP.
- B. Shtimi i këtij kontrolli do të eliminojë rekomandimet e rëndësishme të auditimit në vitin e ardhshëm, kështu që fushëveprimi i aktiviteve të auditimit mund të reduktohet në përputhje me rrethanat.
- C. Aktiviteti i auditimit mund të zvogëlohet nëse zëvendësdrojtori pajtohet të kërkojë miratimin e departamentit të auditimit të brendshëm në të gjitha PSO/SOP e departamentit.
- D. Pyetësorët e PSO/SOP duhet të dërgohen përmes postës elektronike dhe të kontrollohen nga departamenti i auditimit të brendshëm që të merren parasysh në lidhje me orarin e propozuar të auditimit.

37. Në aplikimet e marrjes së mostrave, devijimi standard paraqet masën e:

- A. Shkallës së pritur të gabimit.
- B. Nivelit të besimit të dëshiruar.
- C. Shkallës së ndryshueshmërisë së të dhënave.
- D. Shtrirjes së saktësisë së arritur.

38. Auditorët e brendshëm përdorin nivelet e besimit në kontekstin e marrjes së mostrave të auditimit. Në një plan të caktuar të mostrës, niveli i besueshmërisë është:

- A. Një ndryshore e vendimit që auditori i brendshëm specifikon pas shqyrtimit të pasojave ekonomike të nxjerrjes së konkluzioneve të gabuara si rezultat i gabimit të mostrimit.
- B. Një karakteristikë e popullatës së auditimit dhe nuk është nën kontrollin e drejtpërdrejtë të auditorit të brendshëm.
- C. Në thelb një matje e saktësisë së rezultateve të mostrës të marra pasi që mostra është përzgjedhur dhe testuar.
- D. Nuk specifikohet normalisht para se të përcaktohet madhësia e mostrës. Përkundrazi, ajo kalkulohet pasi që mostra të jetë përzgjedhur dhe testuar.

39. Auditori duhet të marrë një numër vendimesh gjatë përdorimit të mostrimit të veçorive. Termi "efikasitet" përdoret për të përshkruar gjithçka që ndikon në madhësinë e mostrës. Termi "efektivitet" përdoret për të përshkruar gjasat që rezultati i mostrës statistikore do të jetë një vlerësim më i saktë i shkallës së vërtetë të gabimit të popullatës. Supozojmë se një auditor pret një normë dështimi të procedurës së kontrollit prej 0.5%. Auditori është duke marrë një vendim nëse duhet të përdorë nivelin e besueshmërisë prej 90% ose 95% dhe nëse do të vendosë normën e tolerancës së dështimit të kontrollit në 3% ose 4%. Cila nga deklaratat e mëposhtme në lidhje me efikasitetin dhe efektivitetin e mostrimit të veçorive është e vërtetë?

- A. Zvogëlimi i nivelit të besueshmërisë në 90% dhe ulja e shkallës së tolerueshme të dështimit të kontrollit në 3%, do të rezultojë në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit.
- B. Zvogëlimi i shkallës së tolerueshme të dështimit nga 4% në 3%, do të rrisë efikasitetin e auditimit.
- C. Rritja e nivelit të besueshmërisë në 95% dhe ulja e shkallës së tolerueshme të dështimit të kontrollit në 3%, do të rrisë efektivitetin e auditimit.
- D. Rritja e nivelit të besueshmërisë në 95% do të rrisë efikasitetin e auditimit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

40. Një auditor po teston mbi një kartelë të madhe të llogarive të arkëtueshme të një kompanie. Objektivat e auditimit janë të testojnë saldot në fund të periudhës dhe normat e përjashtimit (gabimet) të postimeve të të arkëtueshmeve. Norma e pritshme e përjashtimit të popullatës është 3% për proceset e postimit të llogarive të arkëtueshme. Nëse auditori ka përcaktuar një normë të tolerueshme prej 5%, auditori do të përdorte cilin plan të marrjes së mostrave për testimin e normës aktuale të përjashtimit?

- A. Diferencën ose mesataren e vlerësimit për njësi.
- B. Zbulimin.
- C. Shtresimin.
- D. **Veçoritë.**

41. Shumë firma po fillojnë të përdorin teknikat e kontrollit statistikor të përpunimit si pjesë e qasjes së tyre të përgjithshme të menaxhimit të cilësisë. Cila nga të mëposhtmet nuk do të përbëjë një pjesë të teknikave të kontrollit statistikor të përpunimit?

- A. Mostrimi i pranimeve.
- B. **Mostrimi njësi-valutë.**
- C. Listat e kontrollit të cilësisë.
- D. Monitorimi i vazhdueshëm dhe reagimet.

42. Auditori dëshiron të zgjedhë mostrën njësi-valutë të 100 faturave të shitjeve që janë të përfshira në të arkëtueshmet. Totali i të arkëtueshmeve përbëhet nga 1,600 fatura, duke filluar nga numri i faturës 1781, të klasifikuara në vlerë prej 25€ deri në 3,000€ dhe me një total prej 700,000€. Një listë e pjeshme është:

Nr. Faturës	1781	1790	1795	1804	1805
Shuma	75€	1,400€	1,500€	1,470€	30€
Shuma komulative	75€	1,475€	2,975€	8,450€	8,480€

Duke supozuar se numri katër-shifror 1461, i rastësishëm, është zgjedhur si një pikënisje, dy numrat e parë të faturës për t'u përfshirë në mostër janë:

- A. 1790 dhe 1795.
- B. **1790 dhe 1805.**
- C. 1795 dhe 1804.
- D. 1795 dhe 1805.

43 Auditori i brendshëm identifikon një situatë ku ka dyshime nëse të gjitha shpenzimet e përgjithshme janë alokuar plotësisht në qendrat e kostos nga programi kompjuterik. Procedura më e mirë për të testuar plotësinë e alokimit nga programi është:

- A. Përdorimi i skemës së rrjedhës së punës së kontrolleve.
- B. Hetim i programuesve të sistemeve.
- C. Përdorimi i të dhënave të zgjeruara dhe krijimi i harave.
- D. **Qasja e testimit të të dhënave.**

44. Gjatë një auditimi, auditori i brendshëm duhet të marrë në konsideratë faktorin (faktorët) e mëposhtëm në përcaktimin e shkallës deri tek e cila duhet të përdoren procedurat analitike:

- A. Përshtatshmëria e sistemit të kontrollit të brendshëm.
- B. Rëndësia e fushës që po kontrollohet.
- C. Saktësia me të cilën mund të parashikohen rezultatet e procedurave analitike të auditimit.
- D. **Të gjitha të mësipërmet.**

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

Nga 2 pikë secila

45. Gjatë vlerësimit të vlefshmërisë së llojeve të ndryshme të dëshmive të auditimit, cila nga konkluzionet e mëposhtme është e pasaktë?

- A. Rillogaritja edhe pse shumë e vlefshme, ka dobi të kufizuar për shkak të fushëveprimit të saj të kufizuar.
- B. Vlefshmëria e dëshmive dokumentuese është e pavarur nga efektiviteti i sistemit të kontrollit në të cilin është krijuar.
- C. Dëshmia e dokumentuar e krijuar së brendshmi, konsiderohet më pak e vlefshme se sa dëshmia e dokumentuar e krijuar së jashtmi.
- D. Vlefshmëria e konfirmimeve ndryshon drejtpërdrejtë me pavarësinë e palës që merr konfirmimin.

46. Cila nga format e mëposhtme të dëshmisë paraqet dëshminë më kompetente se një llogari e arkëtueshme ekziston faktikisht?

- A. Një konfirmim pozitiv.
- B. Një faturë e shitjes.
- C. Një raport pranimi.
- D. Një faturë e ngarkesës.

47. Standardet e IIA-së përcaktojnë dëshminë kompetente si:

- A. Faktike, adekuate dhe bindëse.
- B. Të besueshme dhe më të arritshme përmes përdorimit të teknikave të përshtatshme të auditimit.
- C. Në përputhje me objektivat, gjetjet dhe rekomandimet e auditimit.
- D. Informacion që ndihmon organizatën ti përmbush qëllimet e saj.

48. Në një aplikacion të mostrimit sipas variablave (ndryshoreve), cili nga faktorët e mëposhtëm do të ndryshojë drejtpërdrejtë me një ndryshim në nivelin e besueshmërisë nga 90% në 95%?

- A. Gabimi standard i mesatares.
- B. Gabim i mos-mostrimit.
- C. Precizioni (përpikëria) i arritur.
- D. Vlerësimi i pikës së mesatares aritmetike.

49. Cila nga të mëposhtmet siguron dëshmi shtesë?

- A. Dëshmia përfundimtare.
- B. Dëshmia direkte.
- C. Dëshmia plotësuese.
- D. Dëshmia sekondare.

50. Gjatë intervistave me personelin e menaxhimit të stoqeve, auditori mësoi se zyrtarët e shitjes shpesh e porositin inventarin për stokun pa marrë miratimin e zëvendësdrojtorit të shitjeve. Gjithashtu, testimet e detajuara treguan se nuk ka miratime me shkrim mbi urdhërblertjet për pjesët e zëvendësimit. Testimi i hollësishëm (detajuar) është një shembull i mirë i një:

- A. Dëshmie indirekte.
- B. Dëshmie të varur nga rrethanat.
- C. Dëshmia plotësuese.
- D. Dëshmie subjektive.